



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 96 Akti

Nr. 85 Vendimi

Tiranë, më 13.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Lhe Roessingh, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, më datë 11 dhjetor 2018, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 0, salla B, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Emona Muçi, Kryetare dhe Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1.Znj. Emona Muçi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare dhe kryetare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

2.Subjekti i rivlerësimit, znj. Emona Muçi, u shortua, më datë 15 mars 2018, me trupin gjykues nr. 3, të përbërë nga komisionarët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi, Xhensila Pine, relatorë.

3.Trupi gjykues nr. 3, me vendimin nr. 1, datë 22.03.2018, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe të caktojë me mirëkuptim kryesues të trupit gjykues, komisioneren Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në konflikt interesi.

4.U administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (“ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (“DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (“KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Më datë 25.11.2018, trupi gjykues nr. 3, me vendimin nr. 2, vendosi:

- Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Emona Muçi, për të tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe vlerësimin profesional.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi rezultatet e hetimit, bazuar në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, si dhe të drejtën për të marrë një kopje të tyre, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtën për të kërkuar marrjen e provave dhe dhënien e shpjegimeve si dhe thirrjen e dëshmitarëve, brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit.

6.Trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Emona Muçi, më datë 26.11.2018 , me *e-mail*, për vendimin sa më sipër.

7. Subjekti i rivlerësimit, znj. Emona Muçi, dërgoi shpjegimet dhe provat e saj, nëpërmjet *e-mail-it* si dhe në rrugë zyrtare, shpjegime dhe prova, që u administruan nga ana e Komisionit.

8. Më datë 05.12.2018, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, më datë 11.12.2018, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë.

9. Më datë 11.12.2018, ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi.

I. PROCESI I VLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

I/1 VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI

10. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. znj. Emona Muçi, duke krahasuar: “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar etj, të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me institucionet publike.

11. Në përfundim të veprimeve verifikuese të ILDKPKI-së, kjo e fundit bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

I/2 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

12. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

13. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, me qëllim evidentimin e faktit nëse subjekti rivlerësimit arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj dhe personave të lidhur me të, si dhe nëse gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në;
- b) Deklaratat vjetore të pasurisë si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

f) Shpjegimet me shkrim dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

15.Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

16. Apartament banimi, me sipërfaqe 86,7 m², ndodhur në Tiranë, fituar me kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.04.2015, me çmim 61.560 euro, në bashkëpronësi me motrën me ½ pjesë takuese.

17.Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursime nga pagat e vitit 2014 dhe 2015, kontratë huaje në vlerën 5.000 euro, nr. ***, datë 27.04.2015, dhe kontratë kredie bankare, nr. *** rep., datë 14.05.2015, pranë “Union Bank”.

19.Komisioni për vërtetimin e fakteve administroi:

19.Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, me të cilën është kërkuar informacion drejtuar bankave dhe institucioneve financiare.

20. Shkresë nr. *** prot., datë 13.04.2018, me të cilën “BKT” informon se: T.M., O.M., J. ose M.J. kanë pasur/kanë llogari pranë “BKT”-së.

21.Shkresë nr. *** prot., datë 16.04.2018, me të cilën “Union Bank” vë në dispozicion të dhënat bankare për subjektin e rivlerësimit dhe motrën e saj, si dhe të dhënat për huan e marrë prej tyre.

22.Shkresë nr. *** prot., datë 30.03.2018, me të cilën “Raiffeisen Bank” me vë në dispozicion të dhënat bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të.

23.Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar “UKT”-së.

24.Me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2018, “UKT” na informon se në emër të znj. Emona Muçi dhe znj.O.M. është hapur kontratë, më datë 04.11.2015, në Rr. “***”.

25.Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar OSHEE-së, në përgjigje të së cilës me shkresën nr. *** prot., datë 11.04.2018, informohet Komisioni se nuk ka kontratë në emër të subjektit të rivlerësimit.

26.Arsyetimi ligjor:

27.Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues arsyeton se:

28.Subjekti i rivlerësimit, znj. Emona Muçi, së bashku me motrën e saj znj. O.M., më datë 13.04.2015, kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes, nr. ***, me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti, me sipërfaqe 86,7 m², Tiranë.

29.Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për blerjen e apartamentit hua në shumën 5.000 euro, kredi bankare në shumën 43.000 euro dhe kursime nga pagat.

30. Në lidhje me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 5.000 euro, te znj. M.J. (nusja e dajës).

31. Afati i shlyerjes së kësaj huaje është, më datë 31.01.2016.

32. Subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. M.J., për shumën 5.000 euro të marrë hua prej saj.

33. Subjekti i rivlerësimit depozitoi:

33.1 Certifikatë familjare, më datë 08.10.2018.

33.2 Vërtetim datë 09.10.2018, sipas të cilit shtetasi J.J. ka qenë administrator i shoqërisë “****” sh. a., me pagë mujore në shumën 100.000 lekë për vitin 2014 dhe 2015.

33.3 Vërtetim nr. ***, datë 02.11.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan sipas të cilit janë paguar kontribute me pagë të deklaruar për kontributet shoqërore në shumën 105.850 - 97.030 lekë dhe pagë të deklaruar për kontributet shëndetësore 322.000 - 270.000 lekë.

33.4 Vërtetim nr. *** prot., datë 02.11.2018, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan, sipas të cilit z. J.J., për periudhën 2012 - 2018 ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto në shumat nga 87.700 - 105.850 lekë.

33.5 Gjithashtu me kërkesë të Komisionit, z. J.J., konfirmoi dhënien e huas mbesës së tij. Deklarata noteriale e z. J.J., konfirmonte dhënien e huas mbesës së tij duke specifikuar se në ditën kur është dhënë huaja ai e ka pasur të pamundur të jetë prezent prandaj dhe kontrata e dhënies së huas është bërë me bashkëshorten e tij.

34. Ky deklaram përputhet me sa deklaroi, subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin shtesë.

35. Në përfundim, lidhur me huan e deklaruar, marrë në vlerën 5.000 euro, trupi gjykues, çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, të mbështetura në dokumentacionin provues ligjor të depozituar nga subjekti, provojnë burimet e ligjshme të huadhënësit, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 84/2016.

36. Në lidhje me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me motrën e saj znj. O.M., në shumën 43.000 euro me afat 20 vjet, nga “Union Bank”.

37. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të znj. O.M., pranë “Union Bank” rezultoi se, më datë 15.05.2015, është disbursuar kredia në shumën 43.000 euro. Në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k.

38. Në përfundim, lidhur me huan e deklaruar, marrë në vlerën 43.000 euro me afat 20 vjet, nga “Union Bank”, trupi gjykues, çmon se përputhen shpjegimet e subjektit të mbështetura me dokumentacionin provues ligjor të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe të marrë gjatë hetimit administrativ.

39. Në lidhje me të ardhurat e subjektit dhe motrës së saj për të paguar diferencën e pagesës Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin për të vërtetuar aftësinë paguese të motrës së subjektit. Vërtetimin nr. *** prot., datë 02.11.2018, “Vërtetim për bazën e vlerësuar” i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, nga ku rezultoi se znj. O.M. për periudhën

2012 – 2018, ka derdhur kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto në shumat nga 87.700 lekë. Gjithashtu ka depozituar edhe dokumentacion provues për të ardhurat e saj.

40. Bazuar në të dhënat e administruara u krye analiza financiare për blerjen e apartamentit:

	Përshkrimi	2015
1	PASURI	8.282.734
	Apartament, me sip. 86.7 m ² , Rr. "****"	8.473.734
	Pakësim kursime	-740.107
2	DETYRIME	6.511.396
	Hua, M.P.J., shuma 5.000 euro	688.250
	Kredi, "Union Bank", shuma 43.000 euro	5.823.146
3	PASURI NETO (1 - 2)	1.222.231
4	TË ARDHURA	2.474.216
	Të ardhura nga paga shpërblime të subjektit	977.941
	Të ardhura nga paga shpërblime motra e subjektit	1.496.275
5	SHPENZIME	653.053
	Interesa kredie	244.253
	Shpenzime jetese	408.800
	Diferenca (4-3-5)	598.932

41. Bazuar te kjo analizë financiare, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe motra e subjektit kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e apartamentit.

42. Autoveturë, tip "Volkswagen Golf", prodhim i vitit 1998, fituar me kontratë shitje, nr. *, datë 20.02.2013, e paregjistruar.**

43. Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting":

✓ *Kursime personale nga paga, bursa e Shkollës së Magjistraturës.*

44. Komisioni për vërtetimin e fakteve administroi:

45. Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së.

46. Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së.

47. Analiza e provave:

48. Subjekti i rivlerësimit së bashku me motrën e saj, më datë 20.02.2013, ka blerë me kontratën nr. *** së bashku me motrën e saj automjetin, tip "Volkswagen Golf", për shumën 350.000 lekë.

49. DPSHTRR-ja informon se subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë automjet të regjistruar.

50. Në lidhje faktin e prerjes së policave të sigurimit nga ana e z. A.Gj., subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Në përgjigjen e saj ajo sqaron se policia është prerë në emër të ish-pronarit të mjetit pasi nuk është bërë kalimi i pronësisë së mjetit.

51. Më datë 21.11.2018, ajo sqaron si më poshtë: Pas blerjes së mjetit ka parë që ai kishte defekte teknike dhe ka kërkuar anulimin e kontratës me shitësin, gjë që nuk është arritur. Kjo ka qenë arsyeja e fillimit që ajo dhe motra e saj nuk e kanë bërë regjistrimin e këtij mjeti në pronësinë e tyre pasi kanë pasur shpresa se kontrata do të anulohet, gjë e cila nuk ndodhi. Makina nuk u përdor nga ana e tyre, ato e kanë çuar këtë mjet në Ersekë, ku kanë të afërm/njohur, për shkak edhe të vështirësisë dhe kostove të mundshme në lidhje me parkimin e tij. Aty këtë automjet, ato e kanë lejuar që të përdorej me qëllim që të mos dëmtohet krejtësisht nga një i njohur i familjes.

52.Në bazë të të dhënave të administruara u krye analiza financiare për mundësinë financiare të blerjes së këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj:

	Përshkrimi	2013
1	PASURI	784.245
	Automjet, tip “Volkswagen Golf” 50% me motrën	175.000
	Ndryshim likuiditeti	609.245
2	TË ARDHURA dokumentuar	2.101.324
	Të ardhura nga pagat dhe shpërblimet e subjektit	807.290
	Të ardhura nga pagat dhe shpërblimet motra e subjektit	1.294.034
3	SHPENZIME	408.800
	Shpenzime jetese	408.800
	Analiza dokumentuar (2-1-3)	908.279

53.Bazuar te kjo analizë financiare, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e makinës së tyre.

54. Konkluzioni për komponentin e vlerësimit të pasurisë.

55.Trupi gjykues, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficientë dhe proporcionalitetit, në lidhje kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi analizoi dhe vlerësoi provat dhe shpjegimet e paraqitura, arrin në përfundimin se:

56.Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u konstatua se deklaratimet e saj janë bindëse, të sakta dhe në përputhje me ligjin. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

57. Trupi gjykues, çmon se mosregjistrimi i makinës në emër të subjektit të rivlerësimit pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes është një mosveprim që nuk reflekton negativisht në pozicionin e gjyqtarës apo të cenojë besimin e publikut tek drejtësia.

58.Trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

II. VLERËSIMI I FIGURËS

59.Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

60.Konkluzioni për kontrollin e figurës.

61.Komisionit lidhur me këtë kriter nuk i rezultoi ndonjë element dyshues mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

62.Trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

63.Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 26.10.2018.

64.Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- 1) Formulari i vetëdeklarimit, të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

65.Subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së rivlerësimit, për shkak të funksionit që kryen i nënshtrohet detyrimit të pjesëmarrjes në “Programin e Formimit Vazhdues” të Shkollës së Magjistraturës. Ajo ka marrë pjesë në 13 trajnime të kësaj shkolle, gjithsej 24 ditë. Lënda e trajnimit ka një lidhje të mirë me detyrën e gjyqtares së shkallës së parë dhe përfshin njohuri jo vetëm të përgjithshme mbi etikën apo shkrimin ligjor, por edhe fusha specifike të së drejtës tregtare, penale apo administrative. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë edhe në trajnimin “Administrimi i Drejtësisë” i organizuar nga TMC Asser, institut mundësuar nga MATRA-PATROL, në Hagë, Holandë në periudhën 19 - 24.10.2014.

III/1 ANALIZA E GJETJEVE

66.Lidhur me njohuritë ligjore të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë dhe të gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së parë, që i kanë dhënë mundësinë e saj të ketë njohuri ligjore gjyqësore. Njohuritë e saj ligjore konfirmohen edhe nga diplomimi i saj “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2013.

67.Lidhur me tre dokumentet ligjorë të përzgjedhura prej subjektit të rivlerësimit ajo përdor në të gjitha rastet parimet e përgjithshme të së drejtës për interpretimin e normave ligjore, si dhe i mbështet ato edhe me pjesë nga jurisprudenca e gjykatave më të larta në Shqipëri - Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

68.Lidhur me dy vendimet gjyqësore të përzgjedhura prej subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, janë vendime civile, të strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të Kodit të Procedurave Civile, ndërsa një vendim tjetër është penal, i strukturuar sipas elementëve të nenit 383 të Kodit të Procedurave Penale. Secili prej tyre është i ndarë në pjesën hyrëse, përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës.

69.Subjekti i rivlerësimit znj. Emona Muçi, përdor në tekstin e vendimeve gjyqësore shprehimisht parime të përgjithshme të së drejtës siç janë parimi i disponibilitetit të padisë, i barrës së provës dhe kontradiktoritetit në procesin civil, parimi i përparësisë së normave dhe ai i barrës së provës në mosmarrëveshjet e punës, parimi i ligjshmërisë, parimi i ligjit penal favorizues dhe parimi i humanizmit në caktimin e dënimit penal . Gjithashtu, vendimet e saj janë të pasura edhe me citime në jurisprudencën e Kolegjit Civil apo unifikuese të Gjykatës së Lartë, por në 1 rast referenca konstatohet se është e gabuar. Ajo bën pjesë të tekstit të vendimeve gjyqësore çështje procedurale, edhe kur ato nuk janë kundërshtuar nga palët dhe janë koncepte solide nga praktika gjyqësore.

70. Lidhur me aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi në periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, nga tetor 2013 - deri në janar 2014, ajo ka vazhduar kryerjen e stazhit profesional në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ; në periudhën 23.01.2014 - 11.04.2014, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër; në periudhën 11.04.2014 - 26.05.2016, ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë, dhe në vijim në periudhën 27.05.2016 e aktualisht transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec ku ushtron detyrën e gjyqtares. Prej datës 18.11.2016, delegohet nga ana e KLD-së në detyrën e kryetares së kësaj gjykate, ku vazhdon dhe aktualisht.

71.Nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentet ligjorë, rezulton të ketë hartuar 320 akte të relatimit të çështjeve me natyrë civile, akte të cilat konfirmohen se janë nënshkruar nga ana e saj, ndërsa pjesa tjetër e totalit prej 405 dosjesh të relatuara prej saj sipas kancelarit, 83 prej tyre nuk e kanë të përfshirë në to aktin ose relacionin është pa emër, ndërsa nuk u konfirmuan dy çështje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

72. Nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të tre çështjet gjyqësore të zgjidhura me këto vendime, janë përfunduar brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit. Konkretisht, gjykimi i çështjeve ka zgjatur 2 muaj e 4 ditë, 3 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 15 ditë.

73. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë.

74. Lidhur me aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, nga përmbajtja e pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short konstatohet se në çdo rast, ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore që ka relatuar në çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementët proceduralë të kërkuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.09.2014, të kryetarit të kësaj gjykate.

75. Lidhur me aftësinë për të administruar dosjet të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, të pesë dokumentet e përzgjedhur me short, mendimi i subjektit të rivlerësimit ishte i përfshirë në dosjet fizike përkatëse, ndërsa referuar të dhënave statistikore për efekt shorti rezultoi se nga 405 dosje të relatuara, vetëm 320 ishin të nënshkruara nga subjekti dhe të përfshira në dosje, ndërsa pjesa tjetër nuk e kishin të përfshirë në to relacionin.

76. Lidhur me etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi. Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë, kjo edhe për shkak të natyrës së punës. Referuar akteve të vlerësimit profesional për periudhën prill 2014 - prill 2016 gjyqtarja Emona Muçi, në detyrën e ndihmësit ligjor është vlerësuar korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë, si gjatë orarit zyrtar, ashtu dhe jashtë tij. Ajo respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës.

77. Nuk rezultoi në Inspektoratin e KLD-së të jenë paraqitur ndaj saj ankesa për shkelje të etikës gjyqësore në punë apo kërkesa për procedimin e saj disiplinor.

78. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit nuk rezultoi asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Gjithashtu, edhe nga të dhënat e regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

79. Lidhur me integritetin e subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dokumentet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

80. Lidhur me paanësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Nga tre dokumenteve ligjore dhe pesë relacionet e vëzhguara, vetëm një lidhet me çështje të grupeve në nevojë ndërsa çështjet e tjera nuk lidhen në çështje të këtij grupi, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

81. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimi profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi. në të tetë dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit me palët ndërgjyqëse, kjo për faktin se tre dokumentet e paraqitur janë vendime sipas parashikimit ligjor, ndërsa për relacionet e vëzhguara, për shkak të natyrës së punës subjekti nuk ka kontakt me palët ndërgjyqëse. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë. Nga të dhënat e regjistrave të ankesave nuk kanë rezultuar të jenë paraqitur ankesa për shkelje etike nga ana e saj.

82. Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar, në tre dokumentet ligjore dhe në pesë relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike subjekti ka paraqitur aktin e vlerësimit profesional për periudhën prill 2014 - prill 2016 të nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor si dhe nga gjyqtarët anëtarë të Kolegjit Civil, ku pasqyrohet vlerësimi se ajo ka qenë bashkëpunuese me kolegët ndihmës ligjorë, administratën gjyqësore, me gjyqtarët dhe kryetarin e gjykatës. Ka marrë pjesë në trajnime vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe trajnim me temë “Administrimi i Drejtësisë”, në Hagë, Holandë.

83. Lidhur me gatishmërinë për t’u angazhuar, subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik gjyqësor. Ajo ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, më datë 30.06.2004, dhe ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, ku ka marrë titullin “Magjistrat gjyqtar” në vitin 2013. Pas studimeve, më datë 23.01.2014, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, deri më datë 11.04.2014, kur ka filluar të shërbejë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë. Në vijim, më datë 27.05.2016, transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe më datë 18.11.2016 është deleguar kryetare e kësaj gjykate, detyrë të cilën e vazhdon edhe aktualisht. Ajo është treguar e gatshme që të angazhohet në veprimtari të tjera profesionale si mësimdhënie në institucione të arsimit të lartë apo edhe anëtare në Këshillin Ekzekutiv të Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

84.Konkluzione për komponentin e vlerësimit profesional

85.Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të vlerësimit sipas pikës a) trupi gjykues bazuar në (i) konstatimet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se:

86.Trupi gjykues, gjatë analizimit të fakteve për shkaqet ligjore dhe objektive lidhur me, mungesën e kuadrit ligjor në fuqi për përcaktimin e standardeve të punës për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë, konkludon se:

87.Vlerësimi i kriterit profesional, mbështet, në analizimin e projekt-akteve të hartuara prej saj, për aq sa qe e mundur, në çmuarje të burimeve të rivlerësimit sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016.

88.Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Emona Muçi, ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të nenit 59 germa “c” të ligjit nr. 84/2016.

IV. DENONCIME PRANË KOMISIONIT

89. Më datë 22.06.2018, është paraqitur një denoncim nga, znj. S.D., e cila pretendon se veprimet dhe sjelljet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancave gjyqësore janë në shkëlqje të normave procedurale të një procesi të rregullt ligjor.

90.Denoncuesja ka vënë në dispozicion audion e seancës gjyqësore të datës 12.06.2018, ora 12:00, me të cilën ajo, denoncon sjelljen e subjektit të rivlerësimit në seancat gjyqësore.

91.Hetimi i kryer nga Komisioni.

92.Me shkresën nr. *** prot., datë 17.09.2018, drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë, në përgjigje përcillet, vendimi nr. *** prot., datë 22.06.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë “Për mosmiratimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi” me të cilin analizohet qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 12.06.2018, nga gjykata deklarohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit sjellja ka qenë korrekte dhe pretendimet e palës nuk qëndrojnë.

93.Lidhur me pretendimin e kërkuësese se gjyqtarja në mënyrë të përsëritur ka cenuar ato si palë Gjykata e Apelit Korçë është shprehur se është një pretendim i pabazuar referuar përmbajtjes së procesverbalit në audio të seancës të datës 12.06.2018. Sipas kësaj gjykate se kërkuësja, S.D., si e paditur i është drejtuar gjyqtarës me fjalët “*je e njëanshme*”. Në këtë moment gjyqtarja i ka thënë të paditurës që të ushtroj të drejtën e saj për të kërkuar përjashtimin e saj dhe në mënyrë absolute nuk janë përdorur fjalë me përmbajtje kërcënuese.

94.Në lidhje me këtë konflikt interesi Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit e cila në përgjigjet e saj sqaroi se më datë 18.06.2018, është vënë në dijeni se nga pala e paditur është bërë kërkesë për përjashtimin e saj ku si shkak ishte parashtruar se ajo kishte krushqi me paditësin. Pasi ka marrë dijeni për shkakun i ka kërkuar Kancelares së Gjykatës që po atë ditë të vendosej në kontakt me këtë palë për t’i treguar lidhjen e saj me palën paditëse.

95.Më pas është informuar se motra e paditësit, z. K.Ç., është vjehrra e djalit të tezës së nënës së saj. Ndonëse lidhja e mësipërme nuk përfshihej në rastet e heqjes dorë ka vlerësuar të paraqesi kërkesën për heqje dorë. Më datë 21.06.2018, nga ana e kryetares së Gjykatës së Apelit Korçë është vendosur mospranimi i kërkesës për heqje dorë pasi nuk konstatohej asnjë pengesë nga ato të parashikuara nga neni 72/2 i Kodit të Procedurës Civile.

96.Në këtë vendim gjykata argumenton se lidhja e pretenduar nga palët ndërgjyqëse midis mbesës së paditësit dhe një kushërirë të afërt të gjyqtarës nuk është në shkallën e afërsisë gjinore që parashikon ligji dhe në këto rrethana nuk mund të përbëjë pengesë për gjyqtaren në gjykimin e kësaj çështje. Më datë 04.07.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se është vënë në dijeni se ishte depozituar një kallëzim penal nga shtetasja S.D. Në po të njëjtën datë ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi e cila i është pranuar më datë 10.07.2018.

97.Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe dokumentacionin e mëposhtëm për të mbështetur deklaratimet e saj:

97.1 Shortin e datës 18.06.2018.

97.2 Kërkesën për përjashtim gjyqtari, datë 18.06.2018, të z. A.D., i cili kërkon përjashtimin e subjektit të rivlerësimit për qëndrim të njëanshëm dhe konflikt interesi duke deklaruar se pretendimet e tij mund të verifikohen me CD audio të seancave të zhvilluara, më datën 26 prill, 17 maj dhe 12 qershor 2018.

97.3 Kërkesën për dorëheqje nga gjykimi, nr. *** prot., datë 19.06.2018, të subjektit të rivlerësimit drejtuar kryetares së Gjykatës së Apelit Korçë.

97.4 Vendimin nr. *** prot., 22.06.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë, “Për mosmiratimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi”, me anë të këtij vendimi është vendosur mospranimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes civile me palë të paditur, z. A.D. etj.

98.Nga analizimi i audio seancës së datës 12.06.2018, Komisioni, argumenton mbas analizimit të regjistrimit të seancës se thëniet dhe veprimet e subjekti të rivlerësimit në seancë gjyqësore nuk përputhen me etikën e gjyqtarit dhe parashikimet e ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

99. Këto dispozita përcaktojnë se gjyqtari në një proces është i detyruar që të veprojë si një *curia super partes*, dhe nuk duhet të zbrësë nivelin e komunikimit në debat personal me asnjë nga të pranishmit e tjerë. Gjyqtari drejton procesin me vendime, urdhra dhe udhëzime, nëpërmjet të cilave siguron solemnitet dhe rend e qetësi në sallë, ku të gjithë duhet të jenë të bindurit e saj (*curia sententia, summus tacit consetur*).

100. Për sa u konstatua në lidhje me komunikimin e subjekti të rivlerësimit nuk rezultuan të dhëna/prova, që të provonin se veprimet e saj ishin të paramenduara, dhe nuk janë të mjaftueshme:

- ✓ Për t’i çmuar ato si sjellje të përgjithshme dhe të vazhdueshme të subjekti;
- ✓ Për ta vlerësuar atë me mangësi profesionale; si dhe
- ✓ Për ta identifikuar si magjistrate, që ka një praktikë pune të papajtueshme me pozicionin.

101.Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se sjellja dhe etika në këtë seancë gjyqësore përbën shkak për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të saj sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

102. Pranë Komisionit, më datë 02.10.2018, shtetasi F. P, ka paraqitur denoncim për subjektin e rivlerësimit duke deklaruar se ka pushuar gjykimin pa dijeninë e tij.

103. Komisioni analizoi këtë ankim dhe pasi analizoi se ky vendim nuk ishte ankimuar nga palët e kishte marrë formë të prerë duke argumentuar se misioni i Komisionit sipas ligjit nr. 84/2016 nuk është të rishikojë vendimet e gjykatave por të mbledhë të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjekteve të rivlerësimit që janë gjyqtarë, prokurorë, dhe këshilltarë, vlerësoj se ky denoncim nuk plotëson kushtet e nenit 53, pika 2, të ligjit, nuk gjeti indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që çënojnë figurën e gjyqtarës.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

104. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Emona Muçi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

105. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Lhe Roessingh dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, dhe 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
2. Transferimin e çështjes nr. ***, të vitit 2018, pranë organit kompetent për t’u marrë në shqyrtim gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit, znj. Emona Muçi, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Ky vendim, i arsytuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 13.12.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Suela Zhegu
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Xhensila PINE
Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj